



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2023-21

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Titulli i Dosjes: Kërkesë Referuese e Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32, dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Klasifikimi: Publik

Vendim për Gjuhën e Punës dhe Riklasifikim

Parashtruesit

Pjetër Shala

Zyrës Administrative

Fidelma Donlon

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**

Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Maria Raxhiejska

1. Më 10 korrik 2023, në bazë të neneve 31, 32, 54, dhe 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), si dhe rregullave 4(c) dhe 20 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e Punës e DHSGJK-së"), z. Pjetër Shala ("parashtruesi") i dorëzoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") një kërkesë referuese ("Kërkesa Referuese")¹. Parashtruesi përfaqësohet nga z. Zhan-Lui Zhilisen, z. Hedi Auini dhe znj. Leto Kariolu.
2. Më 13 korrik 2023, parashtruesi dorëzoi kërkesë për autorizimin e riklasifikimit të Kërkesës Referuese nga konfidenciale në publike ("Kërkesa për Riklasifikim").²
3. Më 14 korrik 2023, Kryetarja e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, caktoi Panelin e lartpërmendur për të vendosur lidhur me Kërkesën Referuese.³
4. Në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së Punës të DHSGJK-së, Paneli vendos për gjuhët e punës për procedurat e veta. Paneli vëren se parashtruesi e ka bërë kërkesën referuese në gjuhën angleze. Për këtë arsye, gjuha e punës e kësaj procedure do të jenë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, përkatësisht në shqipe, serbishte dhe anglishte, të mundësuar nga Zyra Administrative.

¹ KSC-CC-2023-21, F00001, Kërkesë Referuese e Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32, dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, konfidenciale, 10 korrik 2023.

² KSC-CC-2023-21, F00002, Kërkesë e Mbrojtjes për Riklasifikimin e Parashtrimit KSC-CC-2023-21/F00001 si Publik, publike, 13 korrik 2023. Një korigjim u protokollua më 14 korrik 2023, F00002/COR.

³ KSC-CC-2023-21, F00003, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, konfidencial, 14 korrik 2023.

5. Në përputhje me rregullën 11(4) të Rregullores së Punës të DHSGJK-së, rregulla 82 deri në rregullën 84 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") zbatohen *mutatis mutandis* për klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe provave para Dhomës. Në këtë aspekt, Paneli vëren se, në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet panelit kërkesë për riklasifikim. Duke marrë parasysh parimin e gjykimit publik dhe që Kërkesa Referuese nuk përmban informacion konfidencial, Paneli konstaton se ajo mund të riklasifikohet si publike.

PËR KËTO ARSYE

Paneli i Gjykatës Kushtetuese

1. *Vendos* që gjuha e punës e kësaj procedure të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, përkatësisht në shqipe, serbishte dhe anglishte, të mundësuar nga Zyra Administrative;
2. *Miraton* kërkesën e parashtruesit për riklasifikim; dhe
3. *Udhëzon* Administratoren të riklasifikojë Kërkesën Referuese si publike.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland

Kryegjykatës

Përpiluar në anglishte, të enjten më 20 korrik 2023

Në Hagë, Holandë